

LIGJ
Nr.9325, datë 6.12.2004

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8982, DATË 12.12.2002 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 13 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur mungon dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë, bashkitë/komunat sigurojnë të dhëna nga persona juridikë, fizikë dhe individët, nëpërmjet vetëdeklarimit. Në mungesë të këtyre të dhënave, këshilli i bashkisë/komunës vendos për madhësinë e sipërfaqes së tatueshme nga verifikimet e komisioneve të ngritura prej tyre dhe me metoda të tjera.”.

Neni 2

Pas nenit 25 të shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 25/1

Dispozita të përkohshme

Shkronja "d" e nenit 8 dhe nenet 17 e 18 të këtij ligji do të jenë në fuqi deri më 1 janar 2006.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4429, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu